

UDHËZIM
Nr.40, datë 3.12.2010

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pjesën XIII “Depozitat e karburantit”, pas pikës 54.1 “Naftësjellësit” shtohet pika 54.2 me këtë përmbajtje:

“54.2. Në rast se nafta bruto nuk eksportohet, apo nuk shitet:

a) te rafineritë e naftës në vend, apo

b) te shoqëritë e tregtimit me shumicë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë sipas ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, atëherë kjo naftë bruto do të konsiderohet si “zëvendësues i lëndëve djegëse”, sipas nenit 38 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002”. të ndryshuar, dhe mbi të do të aplikohet tarifa tatimore e akcizës në masën 50 lekë/litri.

Si provë e tregtimit të naftës bruto, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, duhet të shërbejnë kontratat e shitjes me rafineritë, për eksport dhe me shoqëritë e tregtimit me shumicë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode